



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Shpalljes publike për aplikim 12-320-23890 e datës 17.05.2021, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E  
KËRKESAVE TË FERMERËVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE**

**Neni 1**

**Formimi i Komisionit dhe përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim 12-320-23890 e datës 17.05.2021 për ndarje të subvencioneve për vitin 2021- serrave ( në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryesuese
2. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
3. Rrahim Krasniqi, Drejtorati për Administratë, anëtar

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për serra dhe motokultivatorë, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim 12-320-11485 e datës 25.02.2020 dhe legjislacionit në fuqi.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë anese në Komisionin e ankesave brenda afatit 5 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 1-020-30074

Lipjan, 04.06.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

